# VENDIM
## Nr. 136, datë 18.2.2015

## PËRDISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2015 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 1 064 veta ...".

2. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas ndarjes "(21) Shërbimi Informativ Shtetëror" shtohet ndarja "(22) Ministria e Kulturës", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në ndarjet "(3) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes", "(6) Ministria e Drejtësisë", "(18) Institucione të tjera" dhe "(20) Ministria e Zhvillimit Urban" shtohen nënndarjet, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Në ndarjen 11, (Ministria e Punëve të Brendshme), periudha kohore "mars-maj", zëvendësohet me "shkurt-prill".

ç) Në ndarjen 15, (Avokati i Popullit), koha mesatare ditore e punës "4 orë/ditë", zëvendësohet me "6 orë/ditë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**Lidhja nr. 1**

| Emri i Institucionit | Nr. Punonjësve | Emërtesa | Koha mesatare ditore | Periudhë kohore |
|---|---|---|---|---|
| **(22) Ministria e Kulturës** | 34 | | | |
| Aparati | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Aparati | 2 | Teknik i mesëm | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Galeria Kombëtare e Arteve | 3 | Vëzhgues salle | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Teatri Kombëtar | 1 | Punëtor mirëmbajtje | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Teatri Kombëtar | 1 | Mjeshtër butaforist | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Qendra Kulturore përFëmije | 1 | Punëtor mirëmbajtje | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Cirku Kombëtar | 1 | Teknik i mesëm (rrobaqepës) | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Cirku Kombëtar | 1 | Teknik i mesëm (marangoz) | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Cirku Kombëtar | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Cirku Kombëtar | 1 | Veteriner | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Cirku Kombëtar | 1 | Punëtor mirëmbajtje | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Muzeu Historik Kombëtar | 3 | Teknik i mesëm | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Muzeu Historik Kombëtar | 1 | Sanitar | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Muzeu Historik Kombëtar | 1 | Punëtor mirëmbajtje | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| ZAK Butrint | 2 | Vëzhgues (ciceron/guida) | 6 orë/ditë | Maj - Tetor |
| ZAK Butrint | 3 | Punëtor mirëmbajtje | 6 orë/ditë | Maj - Tetor |
| ZAK Parku Arkeologjik Apoloni | 3 | Vëzhgues (ciceron/guida) | 6 orë/ditë | Maj - Tetor |
| ZAK Parku Arkeologjik Bylis | 1 | Punëtor mirëmbajtje | 6 orë/ditë | Maj - Tetor |
| Muzeu i Artit Mesjetar Korçë | 1 | Restaurator | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| QRV Artit | 5 | Restaurator | 4 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| **( 3)Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes** | 1 | | | |
| ATRAKO | 1 | Punonjës pastrimi | 6 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| **(6) Ministria e Drejtësisë** | 2 | | | |
| Komiteti Shqiptar i Birësimeve | 1 | Punonjës pastrimi | 6 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| Komiteti Shqiptar i Biresimeve | 1 | Punonjës informacioni | 6 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| **(18)Agjencia Telegrafike Shqiptare** | 4 | | | |
| Agjencia Telegrafike Shqiptare | 4 | Specialist | 6 orë/ditë | Shkurt - Dhjetor |
| **(20)Ministria e Zhvillimit Urban** | 100 | | | |
| Drejtoritërajonale të ALUIZNI-t | 74 | Specialist | 8 orë / ditë | Mars-dhjetor |
| Drejtoritërajonale të ALUIZNI-t | 26 | Teknik | 8 orë / ditë | Mars-dhjetor |